


D. U. Parlamentit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2019

Lënda: Nismë për propozimin e projektligjit “Për faljen e gjobave të vendosura nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ndaj operatorëve të biznesit ushqimor”

Drejtuar: Z. Gramoz RUÇI

KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Tiranë

I nderuar Z. Kryetar,

Mbështetur në nenin 81 pika 1 të Kushtetutës dhe nenin 68 të Rregullores së Kuvendit, paraqes për shqyrtim dhe miratim në Kuvend projektligjin “Për faljen e gjobave të vendosura nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ndaj operatorëve të biznesit ushqimor”.

Bashkëlidhur gjeni tekstin e projektligjit dhe relacionin shoqërues.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

Deputeti propozues

Ilir Beqaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2019

**“PËR FALJEN E GJOBAVE TË VENDOSURA NGA AUTORITETI KOMBËTAR I
USHQIMIT NDAJ OPERATORËVE TË BIZNESIT USHQIMOR”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

Neni 1

Falen të gjitha gjobat e papaguara, të vendosura nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, në zbatim të nenit 68, pika 1, shkronja “e”, “g” dhe “i”, të ligjit nr. 9863 datë 28.01.2008 “Për Ushqimin”, ndaj operatorëve të biznesit ushqimor, prej datës 1.07.2019 deri më datë 31.08.2019.

Neni 2

Nga përcaktimi i parashikuar në nenin 1 të këtij ligji, përfitojnë të gjitha subjektet të cilët janë të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, por, në momentin e inspektimit nuk kanë qenë të pajisur me licencën për “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, me kodin II.1.A; dhe licencën për “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, me kodin II.1.B, të parashikuara në Aneksin 1 të VKM-së Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar”.

Neni 3

Ngarkohet Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, dhe Qendra Kombëtare e Biznesit për zbatimin e këtij ligji. Procedurat e zbatimit të

faljes së gjobave të papaguara miratohen nga Ministria e Financave me Udhëzim të veçantë brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi të këtij ligji.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYETARI

GRAMOZ RUÇI